

STRUKTURA E STUDIMIT TE TREGUT TE PISHINAVE, FUSHAVE, KOMPLEKSEVE SPORTIVE DHE QENDRAVE TE FITNESSIT

I. Analize tregu ne lidhje me fushat dhe komplekset sportive ne Tirane

Hyrje
Aktoret kryesore te sektorit (fusha dhe komplekse sportive)
Sherbimet e ofruara
Frekuentuesit
Cmimet
Tendenca e fushave apo komplekseve sportive
Konkluzione per sektorin

II. Analize tregu ne lidhje pishinat e hapura/mbyllura ne Tirane

Hyrje
Aktoret kryesore te sektorit (pishinat e hapura/mbyllura)
Sherbimet e ofruara
Frekuentuesit
Cmimet
Tendenca e pishinave te hapura apo te mbyllura
Konkluzione per sektorin

III. Analize tregu ne lidhje me palestrat dhe qendrat fitness ne Tirane

Hyrje
Aktoret kryesore te sektorit (Qendra Fitnes)
Sherbimet e ofruara
Frekuentuesit
Cmimet
Tendenca e shfaqur
Konkluzione per sektorin

Tabela dhe Anekse

Tabela 1: Fushat/kompleset sportive ne ne Tirane

Aneksi 2: Ceshtjet te trajtuara lidhur me studimin e tregut

I. Analize tregu ne lidhje me fushat dhe komplekset sportive ne Tirane

- **Hyrje**

Ky biznes konsiderohet nje biznes relativisht i ri me vetem 3-4 vite zhvillim, por me nje bum ne drejtim te hapjes se fushave te reja ne menyre epidemike ne kuptimin pozitiv te fjales. Ajo cka eshte vertetuar ne dekadën e viteve 90 deri ne 2005 eshte se sukcesi i shume bizneseve eshte kopjuar me perpikmeri nga individe apo biznesmene, por pa berje analziash tregu te mepareshme lidhur me sektoret ku ata intervenuan. Kjo nuk ka perligjur gjithmone suksesin apo deshtimin e bizneseve, por ka krijuar ate treg qe ne te shumten e rasteve ne e etiketojme si kaotik. Ketij fenomeni nuk i shpetoi dhe biznesi i fushave sportive. Te gjitha fushat kane pune dhe frekuentues, por ne kete vorbull frekuentim te mire kane ato qe kane investuar ne shndrrimin e ketyre fushave nga thjesht ambjente loje minfutbolli ne kopmplekse shumsporteshe dhe kenqaesie, por duke afruar dhe sherbime te tjera shtese si bare, artikuj sportive, fitnes, pishina etj. Komplekset me kete medesi ende radhiten me pakice ne Tirane.

- **Aktoret kryesore te sektorit (fusha dhe komplekse sportive)**

Jane ne operim rreth **50-60 fusha sportive** dhe jo me shume se **7-8 te ashtuquajtur komplekse** sportive me jo shume se nje lloj sherbimi apo sporti te ushtruar ne Tirane dhe rrethinat me nje dominace me rreth 50- 60 fusha sportive te shtruara me bar sintetik dhe 130-150 fusha te tjera ne te gjithë Shqiperine pra nje total prej **rreth 200 fushash**. Nderkohe jane ndertuar rreth 10-12 fusha tenisi te shtruara me tartan kryesisht ne shkolla dhe me pak ne komplekse sportive apo hotele turistike (4 vetem prane Hoteleve ne Durres).

Shume nga fushat sportive jane me vendosje ne toka te pronareve Tiranës, ne te ashtuquajtur komplekse sportive apo prane shkollave te mesme te qytetit.

Fillimet keto fusha e kane marre spuntin nga bizneset e para qe paten te perqendruara dhe pishina apo qendra fitnessi pra dy komplekset prane Liqenit te Tiranës Akvadromi dhe Fari. Ne 4-5 vitet e perdorimit te tyre me sukses keto inisiativa me shume interes dhe fitim u perqafuan tashme dhe nga pronare truallesh jo vetem ne Tirane por dhe ne rrethinat e saj.

- **Sherbimet e ofruara**

Fushat sportive qe jane vendosur prane kompkeseve sportive ofrojne dhe sherbime si bar, freskuese, dushe per larje pas aktiviteteve dhe shitje artikujsh sportive si bluza, kepuce dhe topa etj. Cilesia e fushave eshte shume e mire dhe te gjitha kryjne sherbime mirembajtje duke i riveshur ne raste demtimi.

Disa fusha jane te mbuluara cka bejne te mundur frekuentimin e tyre dhe ne kohe me shi por ne sezonin e veres nuk jane shume te preferueshme per mungeses ajri dhe nxetesis te madhe.

- **Frekuentuesit**

Ne keto fusha qarkullojne ne ditte rreth **1.500 persona** qe pelqejne futbollin tip kalceto pra ne keto fusha me bar sintetik me nje cikël ushtrimi **2-3 here ne jave**. Keta persona qe ushtrojne futbollin jane te rinj nga moshë **18-45 vjec** dhe qe zakonisht luajne dy deri ne tre here ne jave Keto fusha konsiderohen mjaft atraktive per te rinjte dhe futbolldashesit dhe frekuentohen dhe nga ekipe te moshave te klubeve te kryeqytetit me pagesa mujore sipas kontratave dhe orarerve te percaktuara me pare .

- **Cmimet**

Cmimet qe aplikojne jane standarte dhe operojne me nje pagese prej **3.000 leke** ora per nje fushe te zene nga **10-12 persona** . Per ekipe te moshave apo klubeve te kryeqytetit jane arranzhuar kontrata mujore me nje cmim te quajtur “shumice”.

- **Tendencat e fushave apo komplekseve sportive**

Tre vitet e fundit kane rezultuar me nje bum ne fushen e investimeve te fushave sportive ne Shqiperi. Investime te tilla jane kryer kryesisht ne Tirane dhe rrethinat e saj me nje dominancë me rreth 50- 60 fusha sportive te shtruara me bar sintetik dhe 130-150 fusha te tjera ne te gjithë Shqiperine pra nje total prej rreth 200 fushash. Nderkohe jane ndertuar rreth 10-12 fusha tenisi te shtruara me tartan kryesisht ne shkolla dhe me pak ne komplekse sportive apo hotele turistike (4 vetem ne Durres).

Kryesisht eshte investuar ne fusha minifutbolli ne masen 90 % dhe pjesa prej 10% ne fusha tenisi, basketbolli etj.

Shkollat e mesme e tetevjecare qe i jane nenshtruar programeve te donatoreve si Soros etj kane plane te reja te investimeve te fushave apo palestrave me shume perdorime sportive.

Kryesisht sipermaresit shqiptare kane bashkepunuar me firmen “**Kevin Sport**” sh.p.k per infrastrukturen e ketyre komplekseve sportive. Kerkesat jane ne rritje ne drejtim te shtrimit te cdo ambjenti te brendeshem apo te jashtem me tartan te tipit Sport impact, bar sintetik cilesor 50 mm lartesi fije dhe me pak cilesor 30 mm lartesi fije.

Konsiderohen investime jo shume te kushtueshme nga **15.000 EURO deri ne 25.000 EURO** ne fusha me permasa **18-36 m** dhe **20-40 m**. Jane investime qe kane shume pak shpenzime, perfshire ketu vetem energjine elektrike dhe nje punonjes mirembajtje dhe mbikqyrje. Nderkohe qe fitimet jane mjaft te mira ne rast te nje marketingu te mire dhe

ofrim sherbimesh shtese si bar bufe, shitje artikujsh sportive, banjo dhe dushe me uje te ngrohte etj.

Firma Kevin Sport partnere eskluive e firmes mjaft prestigioze Mondo LTd Itali si ofruese lidere ne vend e teknologjise dhe materialeve per keto fusha ne tregun shqiptar po ndermer hapa dhe per aksesore te tjer sportive si topa veshje vegla force etj nepermjet firmave partnere ne Belgjike dhe Gjermani, gjithashtu po ofron dhe veshje sportive e kepuce po nga firma prestigioze italiane.

Ndrekohe cmimi i tartanit per shtrim eshte 23-50 EUR/ m2.

Shenim: (Jane ofruar ne kete material dhe nje kendveshtrim i ofruesit te barit sintetik e aksesoreve per fushat sportive ne Shqiperi).

- **Konkluzione per sektorin**

Ende mbetet me interes investimi prane komplekseve sportive ne aaredimin e tyre sipas standarteve europiane me te gjitha aksesoret dhe ambjentett per ushtrimin e shume sporteve dhe aktiveiteteve te kenaqesise. Keshtu trend per te ardhmen mbetet dhe investimi prane ish fushave te shkollave te kryeqytetit, per vete frekuentimin e vazhdueshem te tyre nga te rinjte e Tiranes. Por perqendrimi i tyre ne komplekse sportive do te ishte me me interes sepse ne keto komplese te rinjte mud te bejne dhe dushe apo te kene oferta per fitness, ushtrime force etj Konsiderohen investime me kosto relativisht te vogla dhe gjate perdoimit s'kane shpenzime te medha pervec energise eklektrike etj, por fitimi eshte i konsiderueshem. Edhe lejet e dhena nga Bashkia per keto fusha jane provizore me afat perteritje, se ne rast investimesh publike ato lehtesisht mund te shndrohen ne object ndertimesh pa krijuar humbje per pronaret e tyre.